



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM
NR 62 DATË 11.10.2021

MBI MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË SEGMENTIT “RIKONSTRUKSION RRUGE ME RËRË BITUMINOZE NË FSHATIN POBRAT ME NR PAS 262,263, L=970 ML” ME SEGMENTIN “RIKONSTRUKSION I RRUGËS NGA SHKOLLA E VJETËR DERI NË KRYQËZIMIN E RRUGËS ZYKA ME RRUGËN FITORJA NË FSHATIN CUKALAT.

Këshilli Bashkiak Dimal në mbledhjen e tij të datës 11.10.2021 duke u bazuar dhe mbështetur në materialin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit pranë Bashkisë Dimal si dhe propozimit të Kryetarit të Bashkisë „nenit 54, neni 55 Ligjit Nr 139/2015” Për Vetëqeverisjen Vendore”, në mbështetje dhe zbatim të projektit të rikonstruksionit të rrugëve me rërë bituminoze në fshatrat e Bashkisë, në zbatim të kontratës me Nr 236/21 datë 20.04.2021, i cili përshin disa segmente të shpërndara në territor, del e nevojshme miratimi dhe përfshirja në këtë kontratë të një segmenti tjetër pasi një prej segmentëve përkatës është trajtuar nga FSHZH.

VENDOSI:

Me 13 vota PRO nga 13 Këshilltarë prezentë në mbledhje të miratojë :

1. Të miratojë ndryshimin e segmentit “Rikonstruksion rruge me rërë bituminoze në fshatin Pobrat me nr pasurie 262,263 L = 970 ml” me segmentin “Rikonstruksion i rrugës nga shkolla e vjetër deri në kryqëzimin e rrugës Zyka me rrugën Fitorja në fshatin Cukalat ”
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Administrata e Bashkisë.

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Hysen Hoxha

